



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, , nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 30 e datës 15 qershor 2008, nenit 6 të Udhëzimit administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.04.2023, pas shqyrtimit të propozimit Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

**VENDIM
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARES SË KOMISIONIT**

Neni 1

Me këtë Vendim, **zëvendësohet** anëtarja e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve/eve dhe zëvendës drejtorëve/eve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për vitin shkollor 2022-2023, Drita Islami, në numrin rendor 2, e emëruar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.020/01-52750 të datës 28.09.2022 për formimin e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit, konform edhe kërkesës së Drejtoratit Komunal për Arsim të datës 12.04.2023 dhe në vend të saj caktohet:

Biha Azemi , Drejtoreshë e Institutit të edukimit dhe arsimimit parashkollor publik (Çerdhja e fëmijëve) në Lipjan.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i komisionit është i përcaktuar me dispozitat e Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.020/01-52750 të datës 28.09.2022 për formimin e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit .

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-22352

Lipjan, më 28.04.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

Daut Azemi

